



Projekti: “Ndjekja dhe verifikimi i premtimeve të fushatës zgjedhore në Shqipëri”

Projekti ndihmon qytetarët shqiptarë që të gjejnë dhe regjistrojnë premtimet elektorale të politikanëve shqiptarë. Projekti ofron mjete dhe mundësi për të verifikuar realizimin e këtyre premtimeve.

Qëllimi është që të mbahen nën përgjegjësi lidhur me premtimet deputetët e parlamentit shqiptar dhe të zgjedhurit lokalë, kryetarët e Bashkive.

Këtij qëllimi i shërben përgatitja e buxheteve qytetare, që janë versione të thjeshtuara të buxheteve bashkiake për vitin 2020. Nëpërmjet këtyre buxheteve qytetarët do të kuptojnë më mirë mënyrën e shpenzimeve dhe se si shpenzohen taksat e tyre.

Ju lutemi të gjeni në këtë dokument buxhetin e thjeshtuar qytetar të Bashkisë Kuçovë.

Ju falenderojmë për mbështetjen dhe bashkëpunimin!

Buxheti Qytetar i Bashkisë Kuçovë, Viti 2020:

1. Analiza e parashikimit të të ardhurave për vitin fiskal 2020

Studimi ka për qëllim të analizojë parashikimin për të ardhurat e vitit 2020, e cila do të na ndihmojë të shohim se ku janë përfitimet, problematikat dhe pritshmëritë.


Bazuar në Ligjin nr. 9632, “Për sistemin e taksave vendore”, bashkitë kanë të drejtë të vendosin taksat e tyre +/- 30% nga taksa e miratuar në Ligj, ndërsa tarifatat mund të rriten, zvogëlohen, shtohen apo hiqen me miratim të Këshillit Bashkiak, sipas nevojave të Bashkisë.

Tabela 1. Të ardhurat totale të Bashkisë sipas burimeve, /000 lek

Burimet e financimit	Viti 2019	Viti 2020	Diferenca 2020-2019
Transferta e pakushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të lirë)	157,761 (38%)	161,955 (31%)	4,194
Transferta e kushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	-	39,752 (8%)	39,752
Transferta e pakushtëzuar sektoriale (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	110,593 (26%)	111,934 (21%)	1,341
Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore (të ardhurat nga detyrimet e qytetarëve kundrejt Bashkisë)	110,493 (26%)	175,855 (33.5%)	65,362
Të ardhura të tjera (të ardhura nga institucionet që Bashkia ka nën varësinë e saj)	40,772 (10%)	35,900 (6.8%)	-4,872
Total	419,619	525,396	105,777


Burimi: Bashkia Kuçovë, 2020, llogaritje EIC

Figura 1. Të ardhurat totale, Bashkia Kuçovë 2019




Burimi: Bashkia Kuçovë (Ilogaritje EIC)

Figura 2. Të ardhurat totale, Bashkia Kuçovë 2020



Burimi: Bashkia Kuçovë (Ilogaritje EIC)

Figura 3. Të ardhurat totale për vitet 2019-2020



Burimi: Bashkia Kuçovë (llogaritje EIC)

Më poshtë është dhënë parashikimi mbi të ardhurat nga taksat dhe tarifatat, duke zbritur të ardhurat nga gjobat, insitucionet e varësisë dhe shërbimet e ofruara nga Bashkia.

Tabela 2. Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat

Njësia vendore	Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat 2020
Bashkia Kuçovë	175,855 (të ardhurat pa gjobat dhe të ardhurat e tjera vendore)
	Të ardhurat vendore
	192,983

Burimi: Bashkia Kuçovë (llogaritje EIC)

Tabela 3. Lista e taksave vendore (detyrime që paguajnë qytetarët për shërbimet e marra nga Bashkia)

(Bilanci 2019 është i pritshëm, pasi sipas Ligjit mbi dorëzimet e bilanceve, bilanci i mbyllur i vitit 2019 dorëzohet deri më 31 Mars 2020. Më pas del vlera reale).

Nr.	Taksat vendore	Plani i pritshëm 2019 në /000 Lekë	Plani 2020	Diferenca 2020-2019 në 000/Lekë	Diferenca në % 2020-2019	% mbi tot. e të ardhurave vendore
1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	605	1,000	395	65	0.5
2	Taksa mbi ndërtesat	6,500	11,448	4,948		
3	Taksa mbi tokën bujq.	6,500	13,056	6,556	101	6.8
4	Taksa vendore në shërbimin hotelier	130	200	70	54	0.1
5	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	5,450	7,000	1,550	28	3.6
6	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë	19	-	-19	-100	0.0
7	Taksa vjetore e regjistrimit të automjeteve	12,014	10,000	-2,014	-17	5.2
8	Taksa për zënien e hapësirës publike	500	1,205	705		0.6
9	Taksa e tabelës	200	418	218	109	0.2
10	Taksa e rentës minerare	490	2,300	1,810	369	1.2
11	Të tjera	677	711	34	5	0.3
	TOTALI	51,308	111,119	59,811	117	57.6

Burimi: Bashkia Kuçovë (llogaritje EIC)

Tabela 4. Lista e tarifave vendore (detyrime fikse që paguajnë qytetarët për shërbimet e marra nga Bashkia)

Nr.	Tarifat vendore	Plani i pritshëm 2019 në 000/Lekë	Plani 2020	Diferenca 2020-2019 në 000/Lekë	Diferenca në % 2020-2019	% mbi tot, e të ardhurave vendore
1	Tarifa për pastrim	29,500	31,692	2,192	7	16.4
2	Tarifa për hapësirat publike (tregu)	7,900	8,200	300	4	4.2
3	Tarifë ndriçimi rrugor	9,795	10,629	834	9	5.5
4	Leje transporti	390	220	-170	-44	0.1
5	Tarifë gjelbërimi	8,717	7,685	-1,032	-12	4.0
6	Tarifa për reklamë	150	130	-20	-13	0.1
7	Tarifa parkimi	370	300	-70	-19	0.2
8	Tarifa për therjen e bagëtive	3	-	-3	-100	-
9	Tarifë për shërbime të tjera administrative	-	2,020	2,020	0	1.0
10	Tarifë për shërbime kanale kulluese	570	2,580	2,010	353	1.3
11	Tarifa të tjera (supervizim, lëndë drusore, arkiv, etj)	1,650	1,280	-370	-22	0.7
12	Tarifa lokale	140	-	-140	-100	-
	TOTALI	59,185	64,736	3,359	5.7	33.5


Burimi: Bashkia Kuçovë (llogaritje EIC)

Tabela 5 Lista e të ardhurave të tjera vendore (të ardhura nga shërbimet që ofron Bashkia/gjoba dhe institucionet vartëse)

Nr.	Të ardhura të tjera vendore	Plani i pritshëm 2019 në 000/Lekë	Plani 2020	Diferenca 2020-2019 në 000/Lekë	Diferenca në % 2020-2019	% mbi tot. e të ardhurave vendore
1	Qera tokë bujqësore/pyjore	2,950	12,328	9,378	318	6.4
2	Të ardhura nga gjobat	1,355		-1,355	-100	-
3	Kopshte, çerdhet	4,940	4,800	-140	-3	2.5
4	Të ndryshme (sekuestrime, debitore)	10,527	-	-10,527	-100	-
5	Të tjera/e trashëguar	21,000		-21,000	-100	-
	TOTALI	40,772	17,128	-23,644	-58.0	8.9


Burimi: Bashkia Kuçovë (llogaritje EIC)

Figura 4. Të ardhurat vendore në vlerë 2019-2020




Burimi: Bashkia Kuçovë (llogaritje EIC)

Figura 5. Të ardhurat vendore si % mbi totalin e të ardhurave vendore



Burimi: Bashkia Kuçovë (llogaritje EIC)

Figura 6. Diferenca e të ardhurave vendore



Burimi: Bashkia Kuçovë (llogaritje EIC)

Një element tjetër i rëndësishëm për të ardhurat në buxhetin e bashkive është edhe transferta e pakushtëzuar dhe ajo specifike, e cila ndihmon ndjeshëm njësitë vendore në përmbushjen e planeve të investimeve dhe shpenzimeve.

Tabela 5. Transfertat qeveritare (fonde të deleguara nga Qeveria për Bashkitë)

Emërtimi	2020	% mbi Tot. Ardh.
Transferta e pakushtëzuar	161,955	(31%)
Transferta e kushtëzuar	39,752	(8%)
Transferta specifike	111,934	(21%)

Burimi: Bashkia Kuçovë (llogaritje EIC)

2. Analiza e shpenzimeve të Bashkisë Kuçovë për vitin fiskal 2020

E rëndësishme për qytetarët është procesi i shpërndarjes së fondeve, ose e thënë ndryshe, ku shkojnë paratë e taksapaguesve; përse shpenzohen nga bashkia?


Analiza më poshtë do marrë në konsideratë shpenzimet afatshkurtra dhe ato afatgjata për vitin 2020. Më poshtë po japim tabelën përmbledhëse të shpenzimeve:

Tabela 6. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programeve dhe raporti mbi të ardhurat totale

Emërtimi i shpenzimit	Viti 2019 në 000/Lekë	Viti 2020 në 000/Lekë	Diferenca në vlerë në 000/Lekë	Diferenca në %	% mbi Tot. Ardh.
Shpenzime Paga+Sig.Shoqërore	234,947	245,235	10,288	4.4	46.7
Shpenzime Korrente	207,521	178,382	-29,139	-14.0	34.0
Shpenzime për Investime	47,956	100,947	52,991	110.5	19.2
TOTAL	490,424	524,564	34,140	7.0	99.8


Burimi: Bashkia Kuçovë (llogaritje EIC)

Figura 7 Diferenca e shpenzimeve për vitin 2019-2020



Burimi: Bashkia Kuçovë (Ilogaritje EIC)

Figura 8 Shpenzimet totale si raport mbi të ardhurat totale



Burimi: Bashkia Kuçovë (Ilogaritje EIC)

Më poshtë po japim shpenzimet e Bashkisë sipas Programeve:

Tabela 7. Shpenzimet sipas programeve dhe si % ndaj Tot.të ardh.vendore

Shpenzimet Bashkia Kuçovë	Vlera	% ndaj TA vendore
Planifikim, menaxhim, administrim	54,602	10.4
Çështje financiare dhe fiskale	15,398	2.9
Gjendja civile	3,810	0.7
Policia Bashkiake	39,825	7.6
Planifikimi dhe menaxhimi i territorit	9,778	1.9
Shërbime publike vendore	19,633	3.7
MNZSH	14,532	2.8
Shërbime bujqësore, inspektimi, ushqimi	4,734	0.9
Administrimi i pyjeve	3,875	0.7
Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit	12,849	2.4
Mjedisi	5,397	1.0
Menaxhimi i mbetjeve	112,713	21.5
Mbrojtja sociale	9,007	1.7
Gjelbërim	16,965	3.2
Mirembajtje e ambjenteve shkollore	2,842	0.5
Ndriçimi publik	22,292	4.2
Mirëmbajtje e rrjetit rrugor	31,029	5.9
Spektori ekonomik i arsimit	27,466	5.2
Arsimi parashkollor, bazë	72,628	13.8
Arsimi i mesëm	6,762	1.3
Qendra ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara	2,622	0.5
Çerdhe	13,775	2.6
Sporti	13,196	2.5
Qendra kulturore	8,836	1.7
Total	524,564	99.8

Burimi: Bashkia Kuçovë (llogaritje EIC)